VENDIM
Nr. 94, datë 17.6.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË DËMIT EKONOMIK NGA OPERATORI I SISTEMIT, SI PASOJË E NDËRHYRJEVE TË PALIGJSHME NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, nenit 68, nenit 77, pika 9, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe në zbatim të nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.6.2016, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike të ERE-s, në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e "Metodologjisë së llogaritjes së dëmit ekonomik nga operatori i sistemit, si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e shpërndarjes",

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e "Metodologjisë së llogaritjes së dëmit ekonomik nga operatori i sistemit, si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e shpërndarjes".

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti